

Deklarata politike nga “Iniciativa Qytetare Lëvizja për Drejtësi”

Deklarata Politike nga “Iniciativa Qytetare Lëvizja për Drejtësi” (ILD), është formuar si rrjedhojë e shumë proceseve politike të njëpasnjëshme të cilat kanë degraduar skajshmërisht themelin e institucionit, kulturës dhe drejtësisë, transparencës dhe shërbimin ndaj qytetarit.

ILD, është formuar nga figura intelektualesh dhe profesionist të fushave të ndryshme, me synim të rikthimit të sundimit të ligjit dhe zhvillimit ekonomik me një administratë transparente dhe aktive në shërbim të qytetarëve të vendit.

ILD, synim parësor brenda platformës së saj ka:

1. Ofrimin e kushteve optimale për një jetesë të mirë ndaj çdo qytetari të komunës sonë;
2. Investime të barabarta infrastrukturore dhe shërbim të mirëfilltë për gjithë qytetarët e komunës sonë, pa dallim nacionaliteti, politik apo grup të veçanta;
3. Rritje të cilësisë në fushën e arsimit, ku çdo nxënës i shkollave të mesme, t’i mundësohet praktika në institucionet komunale, konform drejtimit të shkollimit si dhe certifikim mbi punën praktike nga institucionet Komunale